



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Promijeno Me Dana 09-10-2024			
Nr. Dokument Gj. Rr.	Nr. Proq.	Shitje e Pracit	Vlera Vendnost
02-	035/	02-	1182



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Vitia

Kryetari i Komunës në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L – 040, dhe Ligjit nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Rregullores (QRK) nr.23/2023 për procedurat e punës në tryezat multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit, dhe neni 51.1 të statutit të Komunës së Vitisë, 01 - 013/491 të dates: 21.04.2011- Kryetari i Komunës së Vitisë merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet themelimi i Tryezës Multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit.
2. Sipas pikes 1 të këtij vendimi, Tryeza Multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit ka këtë përbërje:
 - 2.1. Menaxheri i rastit nga Qendra për Punë Sociale;
 - 2.2. Ndihmës menaxheri i rastit nga Qendra për Punë Sociale;
 - 2.3. Zyra për Mbrojtje dhe ndihmë të viktimave – Mbrojtësi i Viktimave;
 - 2.4. Shërbimi Sprovues i Kosovës-Zyrtari i shërbimit Sprovues;
 - 2.5. Qendra e Mjekësis Familjare – mjekë specialist sipas specifikave të rastit;
 - 2.6. Policia e Kosovës;
 - 2.7. Qendra për Shëndet mendor-specialist i fushës për trajtimin e fëmijëve;
 - 2.8. Drejtoria e Arsimit-Zyrtari për Arsim;
 - 2.9. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale- Zyrtari përgjegjës;
 - 2.10. Psikologu/Punëtori Social/Pedagoku i Shkollës ose përfaqësusi i deleguar nga institucioni edukativo arsimor;
 - 2.11. Zyra për Komunitete dhe Kthim-Zyrtari për Komunitete;
 - 2.12. Institucioni për Strehim Strehim Përkujdesës ose Familja Strehuese;
 - 2.13. Njesia për të drejtat e njeriut – Zyrtar për të drejtat e fëmijëve;
 - 2.14. Përfaqësues të Organizatave Joqeveritare që punojnë në fushën e mbrojtjes së Fëmijës;
3. Sipas pikes 1 dhe 2 të këtij Vendimi, Tryeza Multidisiplinare është nën udhëheqjen e menagjerit të rastit dhe ka këto detyra dhe përgjegjësi:
 - 3.1. Trajton rastet specifike të abuzimit, keqtrajtimit të fëmijëve dhe lënien pas dore, në bazë të interes më të mirë të fëmijës;

3.2. Përcjellë dhe në vazhdimsi, rishqyrton vlersimin e rastit të bërë paraprakisht nga menagjeri i rastit, duke e plotësuar me uinformata të përditsuara varsisht nga ndyshimi i gjendjës së fëmijës apo rrethanave në rast;

3.3. Bashkërendon dhe zhvillon procesin e planifikimit të përbashkët të veprimit për mbrojtje të fëmijës, në përputhje me rrethanat dhe legjislacionit përkatës në fuqi;

3.4. Koordinon ofrimin e shërbimëve për mbrojtje, rehabilitim dhe integrim apo riintegrim të fëmijës, në mënyrë të qëndrueshme dhe përkrah familjet e tyre ose kujdestarin;

3.5. Rishikon planin individual për mbrojtjen e fëmijës në baza mujore, në raste specifike dhe më shpesh;

3.6. Harton raportin vjetor për punën e vet dhe raporton tek Komuna dhe sipas kërkesës edhe tek Ministria së Drejtësisë dhe Kshillit për të Drejtat e Fëmijës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Anëtarët e komisionit
- Qendra për Punë Sociale
- Arkivi Komunal

